

**Vendim nr. 343, datë 30.12.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryetare

Sonila Bejtja, Anëtare

Sandër Beci, Anëtar

në datën 30.12.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (V) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** **VALBONA GJERGJI**, përfaqësuar nga avokat Rezart Tërshana, me prokurë të posaçme.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 2162, datë 19.06.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-2435, datë 24.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15, 18, 43, 44, 49, 131 shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 134 pika 2, 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesja me urdhrin nr. 1560, datë 27.08.2010 të ministrit të Mbrojtjes ka qenë e punësuar pranë Qendrës së Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes, Muzeut dhe Shtëpive të Pushimit (*Qendra*), në pozicionin e specialistes së sekretarisë. Me urdhrin nr. 400, datë 16.03.2011 “Për marrjen në punë me kontratë” është liruar nga kjo detyrë dhe është emëruar specialiste administrimi dokumentacioni në Sektorin e Administratës së Mbështetjes po në këtë institucion.

2. Si rezultat i ristrukturimit të Qendrës, pozicioni në të cilin kërkuesja ishte e punësuar është suprimuar dhe për këtë shkak, me shkresën nr. 949 prot, datë 14.11.2014, asaj i janë shkëputur marrëdhëniet e punës. Pas shkëputjes kërkuesja i ka kërkuar punëdhënësës që të plotësojë dhe t’i dorëzojë librezën e punës. Pas disa kërkesave verbale, rezulton se i është drejtuar me shkresë zyrtare në datën 22.08.2015. Në përgjigje të kësaj shkrese, Qendra, me shkresën nr. 949/1 prot, datë 08.10.2015, ka kthyer përgjigje se nuk e plotëson dhe nuk e dorëzon librezën e punës përderisa palët janë në proces gjyqësor për dëmshpërblimin e pagës dhe nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë lidhur me këtë çështje.

3. Gjatë kësaj kohe kërkuesja ka aplikuar për t’u punësuar pranë qendrës "Observatori për të Drejtat e Fëmijëve" (*ODF*), ku është përzgjedhur për t’u punësuar si kordinatore dhe ku duhet të paraqitet për të plotësuar dokumentacionin përkatës, ndër të tjera edhe librezën e punës. Kjo kontratë pune ishte me afat të caktuar për një periudhë 2-vjeçare, me pagë mujore 50.000 lekë në muaj. Sipas kërkueses, në kushtet kur librezja e punës nuk ishte dorëzuar, punëdhënësi i ri, ODF-ja, ka bërë anulimin e kontratës së punës, për shkak të mungesës së këtij dokumenti.

4. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesëpadi, me objekt detyrimin e Qendrës të plotësojë dhe dorëzojë librezën e punës, si dhe pagimin e vlerës 1 200 000 lekë si dëm nga mosekzekutimi i detyrimit ligjor për plotësimin dhe dorëzimin e librezës së punës, fakt që ka përcaktuar anulimin e kontratës paraprake të punës ndërmjet saj dhe qendrës ODF. Në përfundim të gjykimit gjykata e shkallës së parë, me vendimin nr. 2162 (80-2016-2149), datë 05.05.2016, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e të palës së paditur që të realizojë veprimin administrativ, të plotësojë dhe t’i dorëzojë paditëses librezën e punës, si edhe ta dëmshpërblejë atë në vlerën 1.200.000 lekë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, Qendra.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2162, datë 19.06.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, rrëzimin e padisë për sa i përket

kërkimit për shpërblimin e dëmit dhe lënien në fuqi të detyrimit për plotësimin dhe dorëzimin e librezës së punës.

6. Për rekursin e kërkueses Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2435, datë 24.06.2025, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbush kërkesat e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

7. Në datën 20.10.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkueses

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit pa dhënë asnjë argument se përse pretendimet e kërkueses të parashtruara në rekurs nuk përfshihen në parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012.

8.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë lidhur me trajtimin e institutit të shpërblimit të dëmit. Kjo gjykatë, ndryshe nga shkalla e parë, nuk ka trajtuar pretendimet e kërkueses lidhur me shpërblimin e dëmit si në aspektin e parashikimeve të Kodit Civil (*KC*), ashtu edhe atyre në ligjin nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, të ndryshuar. Vendimi i gjykatës së apelit është alogjik, kontradiktor dhe përbën një precedent të rrezikshëm për trajtimin e çështjeve të ngjashme. Arsytimi i kësaj gjykate se librezë e punës nuk është një dokument i rëndësishëm për fillimin e marrëdhënies së punës është i pabazuar. Edhe Kolegji Administrativ, me arsyetim të kufizuar, ka argumentuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pa dhënë arsye se përse pretendimet e saj nuk përfshihen në këto shkaqe. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë, e ndodhur përpara dy

vendimmarrjeve të ndryshme nga gjykatat e faktit, duhet t'u kishte kthyer përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkueses, duke cenuar për këtë shkak edhe *parmin e sigurisë juridike*.

- 8.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, në formën e “vetëgjyqësisë”, hakmarrjes, pasi kërkueses nuk i është plotësuar dhe dhënë librezë e punës vetëm për faktin se kishte paraqitur padi kundër Qendrës për të kërkuar dëmshpërblim nga zgjidhja e marrëdhënies së punës me këtë institucion. Kjo sjellje diskriminuese nga ana e këtij institucioni është konsideruar e drejtë më pas edhe nga gjykata e apelit.
- 8.3. *E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, e garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, për shkak të interpretimit që gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë u ka bërë dispozitave ligjore lidhur me përgjegjësinë jashtëkontraktore.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i përket *shterimit të mjeteve juridike efektive*, neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës përcakton se Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të

drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017; nr. 56, datë 21.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimi për cenimin e parimit të mosdiskriminimit është parashtruar nga kërkuesja drejtpërsëdrejti në ankimin kushtetues individual, pa qenë shteruar më parë mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkueses nuk mund të merret në shqyrtim.

13. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vlerëson se kërkuesja i ka parashtruar ato në formë dhe substancë në gjykatat e zakonshme, ndaj nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

14. Kërkuesja legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 24.06.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 20.10.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të *së drejtës së aksesit, standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, të garantuara nga nenet 42 dhe 49 të Kushtetutës, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues.

16. Për sa u përket këtyre pretendimeve, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkueses kanë të bëjnë, në thelb, me interpretimin që gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë bërë legjislacionit në fuqi për përgjegjësinë civile për dëmin jashtëkontraktor, si rezultat i mosveprimit të organit të administratës publike për plotësimin dhe dorëzimin e librezës së punës, si dhe arsytimin e tyre në këtë drejtim, Kolegji çmon t’i trajtojë ato në vijim në drejtim *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*

17. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë për shpërblimin e dëmit. Arsyetimi i saj se librezat e punës nuk përbën dokument të rëndësishëm

për fillimin e marrëdhënies së punës është i pabazuar. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka analizuar pretendimet për përgjegjësinë jashtëkontraktore, sipas dispozitave të KC-së dhe ligjit nr. 8510/1999, duke dhënë një vendim alogjik e kontradiktor. Po sipas, kërkueses, Gjykata e Lartë ka kufizuar shqyrtimin në një arsyetim formal lidhur me nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, në cenim të parimit të sigurisë juridike. Në kushtet e ekzistencës së dy vendimmarrjeve të ndryshme të gjykatave të faktit, kjo gjykatë kishte detyrimin të jepte një përgjigje të arsyetuar për shkeljet e pretenduara.

18. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po sipas jurisprudencës së gjykatës vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh, në thelb, shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata ka pohuar gjithashtu se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të shqyrtojë dhe të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këndvështrim të parashikimeve dhe standardeve të mësipërme kushtetuese, në rastin konkret rezulton se kërkesja i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar detyrimin e të paditurës të plotësojë dhe të dorëzojë librezën e punës, si dhe dëmshpërblimin e saj në vlerën 1.200.000 lekë, si dëm i shkaktuar për shkak të anulimit të kontratës së punës, si rezultat i mosdepozitimit të librezës së punës. Në përfundim të gjykimit kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj. Sipas gjykatës së shkallës së parë, kryerja e veprimit administrativ në trajtën e detyrimit të plotësimit dhe dorëzimit të librezës së punës është një detyrim ligjor, i parashikuar në nenet 1 dhe 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 18.03.1967 “Për pajisjen e punonjësve me librezë pune, si dhe plotësimin e tyre”, të ndryshuar (VKM nr. 26/1967). Gjatë gjykimit është vërtetuar se pala e paditur, në kundërshtim me këto dispozita, ka refuzuar t’i plotësojë dhe dorëzojë kërkeses librezën e punës. Si pasojë e këtij veprimi administrativ të paligjshëm kërkesja ka humbur punën e saj, e cila do t’i siguronte një pagë prej 50 000 lekësh në muaj për një periudhë 2-vjeçare, në bazë të kontratës me afat të caktuar të lidhur prej saj dhe ODF-së. Në këto kushte, gjykata ka gjetur të bazuar pretendimin e kërkeses për shpërblimin e dëmit në vlerën 1 200 000 lekë, vlerë kjo që do të përfitohej nga kërkesja në formën e pagës për periudhën e zbatimit të kontratës së sipërcituar.

22. Gjykata e apelit ka gjetur të drejtë konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë për kërkimin për detyrimin e të paditurës, Qendra, që të plotësojë dhe dorëzojë librezën e punës, si një detyrim ligjor që rrjedh nga VKM-ja nr. 26/1967, ndërkohë ka vendosur ndryshimin e këtij vendimi dhe rrëzimin e padisë lidhur me kërkimin për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Në lidhje me këtë kërkim gjykata e apelit ka vlerësuar se që të ekzistojë instituti i shpërblimit të dëmit në vështrim të neneve 608 dhe 609 të KC-së, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative 4 elemente *i)* të ekzistojë dëmi *ii)* personi të ketë vepruar/mosvepruar në mënyrë të paligjshme; *iii)* personi të ketë vepruar me faj; *iv)* ekzistenca e lidhjes shkakësore ndërmjet veprimit/mosveprimit dhe ardhjes së pasojës. Sipas gjykatës, në rastin në gjykim nuk provohen elementet e veprimeve të paligjshme të palës së paditur, me qëllim ardhjen e pasojave të dëmshme. Po sipas saj, për palën e paditur, Qendra, nuk ekziston elementi faj për anulimin e kontratës së punës në datën 25.11.2015 vetëm për shkakun e mosdorëzimit të librezës së punës. Gjykata e apelit ka vlerësuar se në mungesë të librezës së punës kërkesja mund të paraqiste si prova borderotë nga fillimi i marrëdhënies së punës deri në momentin e përfundimit të saj, listëpagesat, akte këto që gjenden pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Kjo gjykatë ka vlerësuar se librezë e punës nuk është dokument i domosdoshëm për fillimin

ose vijimin e një marrëdhënieje pune, kjo bazuar në legjislacionin në fuqi. Po sipas kësaj gjykate, bazuar në vendimin unifikues nr. 12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për interpretimin e nenit 609 të KC-së për pranimin e përgjegjësive civile jashtëkontraktore, duhet të provohet lidhja shkakësore materiale ndërmjet sjelljes veprimit/mosveprimit të paligjshëm e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Referuar këtij neni, nga provat e marra në gjykim nuk u provua se dëmi i pretenduar të jetë shkaktuar nga veprimet e paligjshme e me faj të palës së paditur, Qendra (*shih faqet 22 dhe 23 të vendimit nr. 2162, datë 19.06.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit*). Për rekursin e kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, pasi ka vlerësuar se në të nuk ngriheshin shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

23. Në analizë të vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit dhe ai i Gjykatës së Lartë tregojnë mjaftueshëm rrethanat e faktit, vendimmarrjen e gjykatave, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata e Lartë tregon se pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuësja është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në nenin 58 të ligjit 49/2012. Në këtë kuptim, vlerësohet se kërkuësja ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë për pretendimet e saj për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor si rezultat i mosdorëzimit të librezës së punës në përputhje me parashikimet ligjore dhe praktikën unifikuese të kësaj gjykate. Interpretimi që gjykatat i kanë bërë legjislacionit të zbatueshëm në çështjen e kërkueses nuk rezulton arbitrar në këndvështrimin kushtetues, i tillë që të këtë cenuar të drejtën e saj për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme. Ndërkohë që vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim cenimin e standardit të arsyetimit, si aspekt i së drejtës për proces të rregullt.

24. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkueses për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme janë haptazi të pabazuara.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkueses nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.